



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 23, datë 27.02.2020

PËR

MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË ZJ. EDLIRA KONINI, SI ANËTAR I KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT DHE ADMINISTRATOR I SHOQËRISË “RAIFFEISEN INVEST - SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 24, 25 të Ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, neneve 16, 17 dhe 18, të Ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e riemërimit të zj. Edlira Konini, si anëtar i Këshillit të Administrimit dhe Administrator i shoqërisë “Raiffeisen Invest-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” sh.a., për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ervin METE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI